



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1444 prot.

Tiranë, më 15/03/2020

URDHËR

Nr. 174, datë 15.03.2020

PËR

**CAKTIMIN E KOORDINATORIT PËRGJEGJËS PËR ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË ANESTEZI - REANIMACIONIT NË KUADËR TË TRAJTIMIT TË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat “ç” të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve në kuadër të shpalljes së gjendjes së epidemisë me Urdhërin nr. 156/2 datë 11.03.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

1. Ngarkohet Dr. Krenar Lila, mjek reanimator pranë QSUT, Koordinator përgjegjës për organizimin e punës së shërbimit të anestezi - reanimacionit në të gjithë strukturat spitalore shëndetësore, që do të trajtojnë personat me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.
2. Koordinator përgjegjës organizon punën me drejtoritë spitalore dhe ekspertët e angazhuar në këtë situatë për kapacitet e pajisjeve mjekësore të secilit shërbim reanimacioni në spitalet e planifikuara sipas skenarëve të miratuara nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, në të gjithë strukturat shëndetësore, që do të trajtojnë personat me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.
3. Të organizohet shpërndarja e pajisjeve mjekësore sipas funksionalitetit të tyre në të gjithë strukturat shëndetësore dhe burimet njerëzore të kualifikuara, sipas skenarëve të miratuara nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, që do të trajtojnë personat me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, dhe të gjithë strukturat që trajtojnë pacientë me infeksionin e shkaktuar nga COVID-19.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Ogerta Manastirliu**



Konceptoi: A. Prifti  
Miratoi: A. Njehrrëna  
Konfirmoi: G. Prodani  
Date . . .2020